

# Disa veçori gjuhësore në veprat e Naim Frashërit

Agim Spahiu

9 shtator 2000

## Përmbledhje

Në këtë shkrim autori është ndalur në disa nga veçoritë më të shpeshta gjuhësore në veprat e poetit më të madh të Rilindjes sonë Kombëtare **Naim FRASHËRI**, siç janë: **Lokucionet dhe frazeologjizmat të tipit foljor, përsëritjet e gjymtyrëve të ndryshme, enumeracioni (numërimi), substantivimi, kompozitat etj.**

Në këtë shkrim do të ndalemi në veçoritë më karakteristike gjuhësore të veprës së poetit tonë të madh të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, **Naim FRASHËRI**, siç janë: lokucionet dhe frazeologjizmat foljorë, përsëritjet (redundanca), enumeracioni, substantivimi, kompozitat etj.

Do të ndalemi këtu në ndërtimet e lokucioneve me strukturë: folje + emër; folje + parafjalë + emër; folje + ndajfolje; dhe folje + folje, duke sjellë disa shembuj.

## 1 Lokucionet foljore të tipit: folje + emër

Në veprat e Naim Frashërit del numri më i madh i lokucioneve foljore me këtë strukturë. Gjymtyra e dytë emërore është zakonisht e ngurosur në trajtën e pashquar dhe në ndonjë rast edhe në të shquarën. Mirëpo ne do ti shënojmë ashtu si dalin në veprat e Naimit. Ja disa nga ato, p. sh.: **ka ënda, (e) merr uria, ka mëshirë, vë re, mba vesh, jep dritë, ka kujdes, jap shpresë, (e) bën gati, derdh lot, (i) bie nder, (e) mori etja, (u) bënë shokë/miq, marr pjesë, (e) zë gjumi, mban mëri, (s´) merr vesh, (i) ka hije, gjeti fund, ka shpresë, hedh sytë, (të) zësh ngojë, bëj nder, (i) jap fund, (e) ka mall, (e) zë vrapin, mori vrapnë, (i) dha brengë, heq brengë, s´ka turp, (e) merr arratinë, (i) zu frenë, (e) merr shëndenë, (i) bën nder, mban mëri, hedh sytë, luajti mendje, (u) prish mënç, mblith mëntë, kishte dëshirë, kishte mall, (u) ra zia, (i) zu frenë, bënë fjalë, ngriti krye, mbante mëntë, (i) bëj dëm etj.**

Të ilustruara me shembuj konkretë: Tek hapetë trëndafili, atje **ma ka ënda** të jem, ... (Bagëti e bujqësia); Zemëra s´thuhet zëmrë, po **të mos keshë mëshirë** (Po aty); Nxitojn´ e s´lodhenë kurrë, edhe kur **i mer uria**, ... (Po aty); Papo bariu shumë aherë

**vë re** e **mba vesh** e dëgjon; (Po aty); **I ka marrë etja** shumë, **E qajnë** me lot! (Lulet e verës); Dhe me botën e gëzuar **bëhem shok** edhe **marr pjesë**, (Po aty); Nata është fort e qetë, dhe gjithë **i ka zënë gjumi** (Po aty); **Kë të zësh - ngojë** më parë nga burrat e vërtetë (Historia e Skënderbeut); Ah! **kam frikë** pej mynxyre! Mos nuk i shoh më në jetë (Po aty); ... posi e gjet nga i ati, me të ligat **kish dëshirë**, në jetë njeri s'peshonte (Po aty); Të pakët që shpetuan, u kthyen e **zunë vrapnë**; Mbreti me shokët iku, zuri një vënt të mërguar, po **s'e mori vesh** armiku (Po aty); Prandaj Sulltan Mehmeti i **bënte nder** dhe e donte, dhe gjithë donin si mbreti (Po aty); Ligësi shumë u rrëfye andaj bota **ngriti krye**. (Qerbelaja); S'e **mbani mënt** ç'kini qënë? (Po aty); Mos i **bëj dëm** njeriut kurrë, pa ahere munt të them je i mirë, i urtë e burrë. (Vjersha të ndryshme - Sentenca dhe fabula); Ti pse më bije? Po shko **mblith mëntë**, pse tregonesh i lik? (Po aty); etj.

## 2 Lokucionet foljore të tipit: folje + parafjalë + emër; folje + ndajfolje dhe folje + folje

Lokucionet foljore me këtë strukturë janë më të pakta se ato të sipërsënuarat. Këtu vlen të shënohen disa, si: (e) **ka ndër ment, ra në sëmundje, ra në gjumë, ra ndër hidhërime, del në shesh, (s') e lë në prehje**; (u) **hoq mënjanë, (e) mori përsipër, (i) vjen keq, (i) ra pas, bie poshtë; s'ka të ngjarë** etj.

Ja disa shembuj për ilustrim: **I kam ndër mënt** dhe sot me shtat, me fytyrë. E zeza mynxyrë! (Lulet e verës); Mbretëresha ish drobitur, **ra në sëmundje** e në lëngime. (Historia e Skënderbeut); ... se ka qënë shumë e lig! andaj **ra në hidhërime**. (Historia e Skënderbeut); Vjen një ditë, pa puna e tërë **del në shesh**. (Vjersha); Po ty kamës! **S'të vjen keq?** S'e ke vëllath atë që heq? (Vjersha të ndryshme); i tha: pi, prehu, qetohu, e mos ki keq, Asim Pashë, po **mer shënden** e shërohu; (Historia e Skënderbeut); Mbreti plak **u hoq më një anë**, pa u ngit një trim më këmbë. (Historia e Skënderbeut); Hamza Pasha me Ahmetnë **përsipër e kishin marë** pandehnin ta muntnin mbretinë; (Historia e Skënderbeut); Një është, po ka shumë ngjyrë, duket sikur **s'ka të ngjarë**, ... (Lulet e verës) etj.

Mirëpo, edhe te këto lokucione nuk është e njëjtë shkalla e mëvetësisë së elementeve përbërëse: te disa ajo është zbehur shumë, si p. sh. te lokucionet: **vë re, marr vesh, zë ngoje, (e) kam ndër ment, (i) ka ënda, (më) vjen keq** etj., ndërsa te të tjerat, si **(i) jep dritë, gjeti fund, (u) bën miq, derdh lot, (e) merr arratinë, ra në sëmundje, ra në hidhërime, bie poshtë** etj., mund të dalin në pozicionin ndërmjet ndërtimeve të qëndrueshme dhe atyre të lira. Prandaj shpeshherë në analizën gramatike mund të dalin dilemat: në duhet t'i marrim si elemente të pandashme që formojnë kallëzues të vetëm foljorë, apo si dy gjymtyrë të zbërthyeshme në: folje - kallëzues + kundrinor?!

Sido që të jetë këto të fundit janë në rrugën e gramatikalizimit e të ngurtësimit të elementeve përbërëse, prandaj s'ka arsye të mos konsiderohen lokucione foljore.

**Naim Frashëri** në veprat e tij ka përdorur edhe shumë **frazeologjizma foljorë**, si p. sh.: **(më) shtie hi syvet** (Lulet...); **të shtinte nër duar, në dorë ta vërë** (Historia...); **s'ra në dorë dot, u bë dyll, qafën ta këputni** (Historia...); **në qafë**

e **mori** (Qerbelaja; **me shpirt ndër dhëmbë** (Vjersha të ndryshme; **mblidh mëntë** (Po aty), **heq dorë** etj. Me këto njësi frazeologjike dhe të tjera si këto ai i ka begatuar veprat e tij me këtë thesar të pashtershëm popullor.

### 3 Përsëritja

Është një prej mjeteve më të shpeshta ekspresive të cilën e ka përdorur mjaft dendur Naim Frashëri në veprat e veta, sidomos në *Lulet e verës* dhe në *Qerbelaja*. Këtu dalin të shpeshta përsëritjet e trajtave të njëjta, si p. sh.: O zot i jetës, **shumë durove, shumë durove**, o zemër - gjerë. (Lulet e verës); Do të **vdes, të vdes** për ty. (Po aty); ... **rrini, rrini** pa pushoni. (Qerbelaja); Mendje! mer fushat e malet, **jashtë, jashtë** nga qyteti. (Bagëti e bujqësia); **Pa hape, pa hape** gjinë. (Qerbelaja); **Ver´ o e bukura verë!** (Lulet e verës); **Haj e zeza jetë, haj!** (Po aty); **Na le, o lulezë, na le!** (Lulet...); **Jak, jak** o e vërtetë. (Qerbelaja) etj.

Me përsëritjen e së njëjtës trajtë shprehja fuqizohet dhe e tërheq më shumë vëmendjen e lexuesit. Ndërsa te foljet e përsëritura vihet re edhe aspekti durativ i shprehur zakonisht me eksklamacion.

Në veprat e Naimit i ndeshim *përsëritjet e shpeshta edhe të parafjalëve, të lidhëzave, të pjesëzave* etj., para trajtave të ndryshme emërore, foljore etj., p. sh.: **Me** mirësi, **me** bukuri, **me** gas të madh, **me** duar plot. (Bagëti e bujqësia); Të shoh të fishkur për dhe´, **pa shpirt, pa** gjak, **pa** fytyrë. (Lulet...); **Mos** u zihni, **mos** u shani, **mos** u lëvdohu, **mos** qërtohi. (Bagëti e bujqësia); Çdo lulëzë ka në veh´te, **një** emër e **një** fytyrë. **Një** bukuri, **një** mirësi, **një** shtat, nj´ **erë një** fytyrë. (Bagëti e bujqësia) etj.

### 4 Enumeracioni

Është shumë i theksuar në veprat poetike të Naimit, e sidomos në *Bagëti e bujqësia*. Këtu edhe gjymtyrët kryesore, edhe ato të dytat janë homogjene etj. p. sh.: **Yjt, hëna, djelli**, shenja lindin. (Bagëti e bujqësi); Të shoh **kecërit e shqerrat, deshtë, cjeptë, dhentë, dhitë**. (Po aty...); Kush sjell **gjeth´ e kërthij´ e shkarpa**. (Po aty); **Të këputur, të mejtuar, të grisur e të rreckosur**. (Po aty); Papu, bariu shumë herë **vë re e mban vesh e dëgjon**. (Po aty); ... **pa u lodhur e pa u këputur, pa djersë e pa mundime**. (Po aty) etj.

### 5 Substantivimi i trajtave të ndryshme, e sidomos i atyre mbiemërore

Është mjeti më i shpeshtë gjuhësor që e ndeshim në veprat e Naimit. Ky substantivim është përgjithësisht kontekstual dhe sajohet kryesisht mbi bazën e tipareve a cilësive të njerëzve, frymorëve etj. Këtu i ndeshim më së shpeshti trajtat e substantivuara nga mbiemrat e nyjshëm, si: **E vërteta, e drejta, i urti, i madhi, i ligu, i çpëlari, i varfëri, e zeza, e shkreta, e paudha, të mjerët, të gjorët** etj., p. sh.: Ishte më nj´

anë e **Vërteta**. (Historia e Skënderbeut); **E Drejta** dhe Njerëzia. (Po aty); E drejta vetë rrëfëhet e **të miratë** po njihet.(Po aty); **I ligu** e gënjeshtari, rrëmbyesi e kusari, e **fëlliqura dhe e ndyra** dhe të gjitha **të këqiat**.(Po aty); Popo, ç'hiqnin **të mjerët** (Po aty); **Të mirën** ta gjenjë vetë (Vjersha); **Të gjorët** i mundonje; **të urtët e të pavdirët** (Historia ...); i ra e **zeza** dh' e preu. (Po aty) etj.

Në tekstet e Naimit gjejmë edhe shumë trajta të tjera të substantivuara **nga përemrat, numërorët, ndajfoljet** etj, p. sh.: ... po **të tjerët** muarë dhenë. (Historia...); se dhe **të tutë** gjallë s'vinë. (Po aty); ...**të parin** e Turqvet pruri. (Po aty); **Të pakët** që shpëtuan , u kthyen e zunë vrapnë. (Po aty) etj.

## 6 Kompozitat

Janë mjaft të shpeshta në veprat e Naimit. Ato janë me strukturë të ndryshme, por më të shpeshta janë ato me strukturë: *emër + emër dhe emër + mbiemër* etj.**Luftëdhënës , brengështënës, mësimdhënës, shpirtmadhësia, gënjeshtërmadhja; fatziu, faqezi, fytyrëhënë, zëmth, valëshumë, mendjeshkurtë, shpirtdashur, zemërhekur, sylaroshe, krahëzjarrtë, fjalëmbël, këmbëartë, duarthatë** etj. Ja p. sh.: Yll' i Marrë **luftë-dhënës e brengë shtënës** (Qerbelaja); ...u nisën disa vetë, **mësimdhënës e të tjerë**. (Historia...); më n'an' ish **fytyrë-qari**.(Po aty) **trup bukura sy laroshe**.(Qerbelaja); egërsira **zemër-hekur** (Historia...); ...e më dërgo tatpjetë engjëllin **krah-zjarrt, fjalë-ëmbël, këmbëartë**(Po aty); E pabesë e **zemër ligë** (Historia...); zonjë **përkëdheloshe** (Po aty) etj., të shkruara me vizëlidhëse ose të ndara.

Përpos kompozitave të shumta përcaktore, aty gjejmë aty-këtu edhe ato të tipit **turi e buzëlëshuar**. Mirëpo më të rralla janë kompozitat me vlerë foljore e ndajfoljore të tipit: **fatbardhëson e llërpërveshur** p. sh.: që **fatbardhëson fatbardhësinë**, punonte llërë përveshur.

Në veprat e Naim Frashërit ndeshim një numër të madh fjalësh të prejardhura, si: **mirësia, ligësia, urtësia, madhëria, marrëzia, dhelpëri, gjithësia, djallëzia, bërësi, rrëmbyesi, gënjeshtari, tipari, durimi, mallëngjimi, ngashërimita, pëlumpth, djemth, krahëth, vendëth, miqthit, pulpëz, vashëz, shqerrëz vjedhareke, (miza) përdhese; përndaj, pakësohet, zbukurohetxgjeron, shëmbëllen, paditja, e paudha, çpërblen, çveshje, çbrenjosje, i panderçimi, përzgjerohet, përgëzoj** etj.

Po kështu, në veprat e Naimit mund të ndeshim edhe mjaft **fjalë të përngjitura** të tipit si: **thashetheme, ecejake; gjithënjë, gjithmonë, ndonëse, sidomos** etj.

Në këto vepra, sidomos në *Histori e Skënderbeut*, është shumë e theksuar **ligjërrata e drejtë**, p. sh.: Manushi fjalën ja preu, tha: tani le të mbarojmë, pa i tha mbretit: ngreu, nesër prapë kuvendojmë (Histori...); Asim' Pasha i zu frenë, duke thënë këto fjalë: Të muntnjë e të fitonjë njeriu është punë e mirë, po më mirë të dhuronjë është' e të ketë mëshirë! (Po në këtë vepër) etj.

Në *Lulet e verës* dhe në *Bagëti e bujqësia* Naimi e ka përdorur mjaft shumë **thirrurin e thjeshtë apo të zgjeruar** që ka të bëjë me apostrofin dhe personifikimin si figura poetike stilistike.

Në këto vepra shpesh e ka përdorur togun përemëror: **Përemër i pacaktuar (gjithë)**  
+ **përemër lidhor i pacaktuar Gjithë ç** janë ngjallen, çelen, përsëriten, zbukurohen,  
(Lulet...) etj.